



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2876/ 6 prot.

Datë 20/12/2023

V E N D I M

Nr. 1342/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20/12/2023, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “MEDFAU” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, Loti 2, me Nr. REF-83167-10-11-2023, me objekt: “*Blerje Laborator Levizes (Autolaborator) për Inspektoriatin Shteterorë Teknik dhe Industrial*”, me fond limit 16,166,666 (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 27.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

Ankimues: Operatori ekonomik “MEDFAU” SHPK me NIPT: J93610823R dhe me adresë: *Rruga “4 Dëshmorët”, nr. 195, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara
Adresa: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për*

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.10.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, Loti 2, me Nr. REF-83167-10-11-2023, me objekt: “Blerje Laborator Levizes (Autolaborator) për Inspektoriatin Shtetërorë Teknik dhe Industrial”, me fond limit 16,166,666 (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 27.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

II.2. Në datë 27.10.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 13.11.2023 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “MEDFAU” SHPK 15.800.000 leke skualifikuar

II.4. Në datën 13.11.2023, operatori ekonomik “MEDFAU” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“- Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 4, seksioni 2.3 “Kapaciteti teknik” i Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nga dokumentacioni i paraqitur ne SPE, nuk rezulton që Paretet e mjetit duhet të jene me material anti-korrodues, sic kerkohet ne piken 11 Shtojca 5 “Formulari i specifikimeve teknike” te DST. Nga dokumentacioni i paraqitur ne SPE nga ofertuesi, rezulton se, muret, tavani dhe dyshemeja se bashku me izolimin, jane bere nga materiale qe sigurojne respektimin e kerkesave te standarteve EN 1789 dhe EN ISO 3795, persa i perket ndezshmerise.”.

II.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 15.11.2023 autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në datën 20.11.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3626 dhe me nr. 2876 prot., datë 20.11.2023, e operatorit ekonomik “MEDFAU” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2876/2, datë 21.11.2023, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “MEDFAU” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Me shkresën nr. 1457/4 prot, datë 01.12.2023, protokolluar me tonën me nr. 2876/3 prot datë 07.12.2023, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe vendimi për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “MEDFAU” SHPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.11. Referuar informacionit të sipërcituar të autoritetit kontraktor, rezulton se ky i fundit me shkresën nr. 1457/2 prot, datë 30.11.2023, ka vendosur:

“ [...] ... Pra rezulton se në katalogun e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, lidhur me paretet e mjetit është shprehur lidhur me respektimin e kërkesave për sa i përket ndezshmërisë, por në asnjë moment në këtë katalog nuk përcaktohet se paretet e mjetit të jenë me material anti-korrodues, ashtu si kërkohet në Shtojcën 5, në dokumentet e tenderit. ... [...]”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik “MEDFAU” SHPK, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se: “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre.”, nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoriteti kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “MEDFAU” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të tij se: “- Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 4, seksioni 2.3 “Kapaciteti teknik” i Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nga dokumentacioni i paraqitur ne SPE, nuk rezulton qe Paretet e mjetit duhet te jene me material anti-korrodues, sic kerkohet ne piken 11 Shtojca 5 “Formulari i specifikimeve teknike” te DST. Nga dokumentacioni i paraqitur ne SPE nga ofertuesi, rezulton se, muret, tavani dhe dyshemeja se bashku me izolimin, jane bere nga materiale qe sigurojne respektimin e kerkesave te standarteve EN 1789 dhe EN ISO 3795, persa i perket ndezshmerise.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.2. Në shtojcën 7 “LOTI 2 ME OBJEKT: “BLERJE LABORATOR LEVIZEZ (AUTOLABORATOR)”, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, në pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik të paraqesë **katalog teknik të mallit**, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar. Në katalogë duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) specifikimet teknike, të përcaktuara në Shtojcën 5 të DT”.

III.1.3. Në shtojcën 5 “LOTI 2 ME OBJEKT: “BLERJE LABORATOR LEVIZEZ (AUTOLABORATOR)”, “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike të mallrave objekt-prokurimi, si më poshtë vijon:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
Loti 2 “Blerje Laborator Levizes (autolaborator)”

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Specifikimet teknike për Laboratorin Lëvizës (Autolaboratorin).

1. Kategoria e automjetit

-

- N1, pesha maksimale me ngarkesë deri në 3.5 ton. -
- Motorri Diesel, Euro 6, deri në 3000cc, me katër pistona. -
- Viti i prodhimit 2022-2023. -
- Airbag për drejtuesin dhe pasagjerin. -
- Sistemi i drejtimit, në krah të majtë. -
- Garancia 1 vit deri 100,000 (njëqindmijë) kilometra. -
- Gjatësia e automjetit deri në 7m. -
- Lartësia e automjetit deri në 2.8m. -
- Gjerësia e automjetit deri në 2.4m (përfshirë pasqyrat). -
- Laboratori lëvizës duhet të jetë i përshtatshëm për kryerjen e analizave cilësore të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj. -
- Laboratori lëvizës duhet të jetë i ri, i papërdorur e me km 0 (zero).

- 2. Duhet të jetë i pajisur me goma të reja dhe me një gomë rezervë.*
- 3. Të jetë i pajisur me sistem ABS ose ESP.*
- 4. Shasia e pasme duhet të jetë i pajisur me sistem të përshtatshëm përzullimi për të siguruar pajisjet e laboratorit sipas standardit ISO/TC 16949.*
- 5. Duhet të ketë sistem navigimi GPS ose ekuivalent, për të specifikuar vendodhjen e mjetit, shpejtësinë, konsumin e karburantit dhe fikjen e motorrit.*
- 6. Kabina duhet të jetë me tre ulëse (shoferi + dy pasagjerë) dhe të pajisura me rrip sigurimi për të tre.*
- 7. Kabina duhet të ketë sistem kondicionimi dhe sistem audio.*
- 8. Duhet të ketë një derë rrëshkitëse në krahun anësor dhe dyer me kanate në pjesën e prapme të mjetit.*
- 9. Duhet të jetë i shoqëruar me vegla pune në rast problem mekanik si: krik gomash, aparat për fryrje gomash, celësa, kaçavida etj.*

10. Duhet të jetë i pajisur me kutinë e ndihmës së shpejtë.
11. Paretet e mjetit duhet të jenë me material anti – korrodues dhe dyshemeja e tij duhet të jetë e shtruar me shtresa metali jo-përcjellës të rrymës elektrike si alumini (sipas standardeve në fuqi për mbrotjen nga elektriciteti).
12. Laboratori lëvizës duhet të ketë dedektor tymi, zjarri, monoksidit të karbonit dhe gazeve toksikë volatilë dhe sistem alarmi audio dhe vizual.
13. Duhet të ketë të implementuar pajisjen për fikjen e zjarrit me përmbajtje dioksid karboni me kapacitet të paktën 6 litra dhe një tjetër pajisje për fikjen e zjarrit me pluhur (pudër) të thatë (tip ABC) minimumi 5 kg.
14. Duhet të jetë i pajisur me gjenerator për prodhimin e energjisë, gjithashtu dhe të lidhet në mënyrë të pavarur me energji elektrike të jashtme me tension me anë të kabujve elektrikë me gjatësi jo më të vogël se 25 metra.
15. Gjeneratori elektrik duhet të jetë i aftë për të përballuar funksionimin normal të pajisjeve laboratorike, ndriçimit, ajrit të kondicionuar, ventilimit etj., me një fazë të vetme tension 220 – 240V/50Hz.
16. Autolaboratori duhet të ketë sistem digjital kondicionimi dhe ventilimi në pjesën e prapme (aty ku kryhen analizat) sipas standardit ISO 554, për të siguruar kushte optimale të laboratorit sipas standardeve ndërkombëtare.
17. Duhet të ketë një pajisje matëse për temperaturën me saktësi 0.5°C dhe lagështinë me saktësi 10%RH, shoqëruar me çertifikatë kalibrimi nga një laborator i akredituar sipas standardit ISO 17025 ose një standardi tjetër ekuivalent.
18. Mobiljet e tij duhet t'i kenë kanatet dhe sirtaret të tilla që të mbyllën hermetikisht.
19. Mobiljet e tij duhet të kenë të inkorporuar një frigorifer me kapacitet 80-90 litra për ruajtjen e kimikateve, CRM, etj.
20. Duhet të ketë depozitë shkarkimi për mbetjet ujore me kapacitet jo më të vogël se 20 litra dhe depozitë furnizimi me ujë të distiluar me kapacitet jo më të vogël se 10 litra.
21. Autolaboratori duhet të jetë i pajisur me lavaman dhe depozitë uji me kapacitet jo më të vogël se 10 litra.
22. Duhet të ketë sistem ndriçimi dhe panel kontrolli të tij.
23. Duhet të jetë i pajisur me priza për lidhjen e aparateve me elektricitetin.
24. Duhet të jetë i pajisur me të paktën dy karrige të përshtatshme për kryerjen e analizave.
25. Bankoja e tavolinave, ku do të kryhen përgatitja dhe analizimi i mostrave, duhet të jetë material i qëndrueshëm ndaj veprimit korrodues të kimikateve dhe mostrave.
26. Autolaboratori duhet të jetë i pajisur me sistem operimi Microsoft Ëindoës ose ekuivalent për të përfutur të dhëna nga aparatet, me pajisje të menaxhimit të të dhënave, printimit dhe transferimit të tyre.
27. Duhet të jetë i pajisur me kompjuter portabël/laptop të gjenaratës së fundit, shoqëruar më një lazer printer.
28. Përmasat e hapësirës së brendshme të pjesës së prapme të autolaboratorit (aty ku bëhet testimi i kampioneve) duhet të jenë si më poshtë:
 - Gjerësia: minimumi 1.8m
 - Gjatësia: minimumi 3.5m
 - Lartësia: minimumi 2.0m

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.1.5. Në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.6. Në nenin 40 pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

- “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*
- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*
 - b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*
 - c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.*

III.1.7. Neni 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të

përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim, si dhe hartimi i dokumenteve të tenderit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit te kriteret e veçanta për kualifikim kapaciteti teknik, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin: **“katalog teknik të mallit, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar. Në katalogë duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) specifikimet teknike, të përcaktuara në Shtojcën 5 të DT”**, ndërsa në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi janë përcaktuar specifikimet teknike të produktit objekt-prokurimi, ku një ndër specifikimet teknike të këtij produkti dhe për të cilin ngrihet pretendimi se nuk plotësohet nga ana e ankimesit është përcaktuar si në vijim: **“11. Paretet e mjetit duhet të jenë me material anti – korrodues dhe dyshemeja e tij duhet të jetë e shtruar me shtresa metali jo-përcjellës të rrymës elektrike si alumini (sipas standardeve në fuqi për mbrotjen nga elektriciteti).”**.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat

mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksional sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtë për drejtë me kriterin e veçantë të vendosur. Sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor nuk i ka hartuar dokumentat e tenderit në përputhje me nenin 36 të ligjit për prokurimin publik, pasi lidhur me specifikimin teknik si në vijim: “Paretet e mjetit duhet të jenë me material anti – korrodes”, nuk arrihet që të identifikohet nëse bëhet fjalë për paretet e jashtëm apo të brendshme të produktit objekt-prokurimi, si dhe lidhur llojin e materialit prej të cilit duhet të jetë i përbërë paretit dhe konkretisht termi “anti – korrodes” nuk arrihet të kuptohet se çfarë lloj materiali është pasi fjala nuk është në gjuhën shqipe, gjuhë në të cilën janë hartuar dokumentat e tenderit dhe është fjalë e pakuptimë, duke vënë në vështirësi jo vetëm ofertuesin lidhur me hartimin e ofertës, por edhe Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të ankimuesit.

KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar dokumentat e tenderit të mësipërm në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se specifikimet teknike nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe t'i japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës.

III.1.11. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, sipas të cilit: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të*

drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimitarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se mospërputhja e krijuar midis kërkesave të parashikuara nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike e kritereve të kualifikimit, pjesë e dokumentave të tenderit, ndikon drejtpërdrejtë në hartimin e ofertës ekonomike të operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe në vlerësimin e ofertave nga ana e KVO-së, si dhe është haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, ndaj, përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë konstatimet e këtij vendimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në 10 një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimitarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “MEDFAU” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, Loti 2, me Nr. REF-83167-10-11-2023, me objekt: “Blerje Laborator Levizes (Autolaborator) për Inspektoriatin Shtetërorë Teknik dhe Industrial”, me fond limit 16,166,666 (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 27.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MEDFAU” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri